



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORATI**

**FORMATI I PUNIMIT
BULETINI SHKENCOR UNIEL**

Punimi i plotë duhet të dërgohet në format elektronik në adresën e buletini@uniel.edu.al në formatin e kërkuar si më poshtë, si dhe i shoqëruar me figurat (fotografitë) me cilësi të mirë (në qoftë se ka të tilla). Dorëzimi i punimeve është i hapur për seritë:

- Seria e Shkencave Shoqërore;
- Seria e Shkencave Mjekësore, të Natyrës dhe Biznesit e Drejtësisë;
- Edicioni Special.

Afati i dorëzimit: 31 janar

Afati i dorëzimit për Edicionin Special deri në 31 mars

Punimi nuk duhet të jetë botuar më parë, në asnjë revistë tjetër apo proceedings brenda dhe jashtë vendit.

Vetëm punimi i saktë dhe i plotë pranohet. Ai diskutohet për recensë në mbledhjen e Redaksisë përkatëse. Dy Recensues anonim më afër fushës shkencore të punimit jep mendim me shkrim për cilësinë dhe shkallën e përmirësimit. Autori përgjegjës informohet nga Redaksia, kur punimi ka nevojë për përmirësime ose plotësime të mëtejshme.

Gjatësia dhe madhësia e punimit:	Punimi duhet të shkruhet në Microsoft® Office Word 97-2003 . I gjithë punimi duhet të jetë 3000 – 5000 fjalë.
Gjuha e punimit:	Punimi duhet të shkruhet në gjuhën shqipe të saktë dhe të kuptueshme duke shmangur përdorimin e fjalëve të huaja. Në rast se është domosdoshmëri përdorimi i tyre atëherë është e nevojshme të përkthehen në kllapa ose në “footnote”. Sigurohuni që dorëshkrimi juaj të jetë kontrolluar nga ana drejtshkrimore dhe gramatikore para dorëzimit. Autori duhet të shkruajë si rregull në vetën e tretë duke përdorur si shprehje, si: quhet, kosiderohet, arrihet, në përfundim se, vërtetohet se etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORATI**

	<p>Janë të pranueshme edhe dorëshkrime në gjuhën angleze, kur cilësia e gjuhës plotëson kërkesat, dhe teksti është redaktuar më parë nga një person i autorizuar për gjuhën angleze.</p>
Fonti:	<p>Times New Roman, single line (vijëzimi justified) Shënim: Vijëzimi Justify mund të aktivizohet dhe duke përdorur CTRL+ J</p>
Formatimi i punimit:	<p>Font: 11 Orientation: Portrait Page Layout - Size: B5(JIS), 7,17" x 10,12 Page Layout - Margins: Moderate 1" x 1", 0,75" x 0,75" Text Alignment: Justified</p> <p>Line Spacing: 1,15</p> <ul style="list-style-type: none">• Mos vendosni numër faqesh.• Mos e formatoni tekstin në kolona të shumta.• Mos lini paragrafë. Linjat bosh duhet të lihen vetëm nëse është e nevojshme.• Mos përdorni hapësira të shumta.
Organizimi i punimit:	<p>Elementet që duhet të përmbajë një punim:</p> <ul style="list-style-type: none">• Titulli, autori/ët dhe përkatësitë• Abstrakti dhe fjalët kyçe• Hyrja• Materiale dhe metoda• Rezultatet• Diskutim• Përfundime/ Konkluzione• Referencat/Literatura• Shtojca (t) (nëse aplikohet)
Titulli:	<ul style="list-style-type: none">• Titulli duhet të jetë specifik, korrekt, i kuptueshëm dhe të përçojë idenë qendrore të punimit për lexuesit jashtë fushës.• Titulli duhet të shtypet me germa KAPITALE me font 14 dhe me Bold (germa të theksuara). Titulli i punimit nuk duhet të ketë më shumë se 250 karaktere.• Pas titullit vendosen emrat e autorëve me font 12 dhe me Bold, institucionet përkatëse dhe adresat e plota të tyre me Font 10 dhe Italic• Titulli, autori/ët dhe adresat vendosen në qendër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORATI

Autori/ët:	<p>Të gjithë individët që kanë dhënë një kontribut thelbësor në artikull duhet të listohen si autorë. Ju lutemi shkruani emrin dhe mbiemrin e autorëve, si dhe përkatësinë. Përkatësia përfshin programin e studimit, universitetin ose vendndodhjen e tij, duke përfshirë qytetin, shtetin.</p> <ul style="list-style-type: none">• Mos listoni gradat akademike, adresat personale dhe e-maillet.• Emri mbiemri i autorit/ëve duhet të shkruhen me Font 12 Bold.• Përkatësitë e autorit/ëve duhet të shkruhen me font 10 dhe Italic.
Përmbledhja / Abstrakti:	<p>Abstrakti duhet të përshkruajë objektivin (at) kryesorë të studimit, të shpjegojë se si është kryer studimi dhe të përmbledhë rezultatet më të rëndësishme dhe rëndësinë e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none">• Abstrakti nuk duhet të kalojë 300 fjalë ose të përfshijë citime.• Në punimet në gjuhën shqipe përmbledhja/abstrakti duhet të paraqitet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.• Përmbledhja/abstrakti duhen me Font 11 dhe Italic.
Fjalët kyçe:	<ul style="list-style-type: none">• Punimi duhet të ketë jo më shumë se 5-7 fjalë ose fraza kryesore kyçe të cilat pasqyrojnë thelbin e punimit.• Fjalët kyçe ose frazat kryesore duhet të ndahen me presje.• Vetëm emrat, mbiemrat dhe shkurtesat e duhura duhet të shkruhen me shkronja të mëdha.
Titujt dhe nëntitujt e punimit:	<ul style="list-style-type: none">• Titujt shkruhen me shkronja të mëdha, shkronja të zeza (Bold), pas një rreshti bosh.• Nën-titujt shkruhen me shkronja të pjerrëta, me fjali. Ato numërohen duke përdorur numra arabë (1, 1.1, 1.2, 1.2.1..., 2, 2.1...).• Kufizoni pjesët dhe nën-seksionet e dorëshkrimeve në 3 nivele titulli.
Punimi:	<p>Në hyrje bëhet një paraqitje e hollësishme e rëndësisë së problemit që do të jetë në qendër të punimit. Hyrja duhet të përshkruajë shkurt bazën për punën e paraqitur. Në hyrje tregohen objektivat dhe arsyet e ndërmarrjes së studimit, struktura e punimit, si dhe shkurtimisht rezultatet e marra, diskutimet e kryera dhe të rejat që sjell punimi.</p> <p>Sfondi teorik: Në këtë pjesë bëhet një përshkrim i përgjithshëm i rishikimit të literaturës dhe vendoset tema e propozuar. Në punën kërkimore gjithnjë fillohet prej një baze teorike që është mbizotëruese në një fushë të caktuar shkencore.</p> <p>Formulimi i problemit dhe qëllimeve të punimit: Problemi shkencor duhet të përkufizohet qartë, saktë dhe mirë. Qëllimet e punimit duhet të jenë të harmonizuara me problemin. Parashtrimi i problemit edhe nëse ai qëndron si i tillë, duhet të jenë të lidhura kuptimisht me qasjen teorike, por edhe me hipotezat dhe metodat e parashikuara të kërkimit.</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORATI

Pyetjet dhe hipoteza: Pyetja e punimit duhet të formulohet qartë. Ajo duhet të nënkuptojë një hipotezë kërkimi që mund të verifikohet. Hipoteza e kërkimit duhet të jetë e formuluar saktë, në mënyrë që të shmanget dykuptimësia dhe kërkesat shtesë. Është e rëndësishme që gjetjet të paraqiten në mënyrë të tillë që mund të arrihet në përfundime. Në kërkimet cilësore është e rëndësishme që të kuptohen drejt dukuritë e hulumtuara dhe të tregohet se përvojat që pasqyrohen në to ndihmojnë të kuptuarit dhe lejojnë mbërritjen në përfundime të caktuara. Nëse përdorim kërkime sasiore apo një përzierje të të dyjave, është gjithashtu e rëndësishme të përcaktohet një numër kriteresh përmes së cilave një hipotezë pohohet ose mohohet.

Materiali dhe Metoda duhet të paraqiten në mënyrë të detajuar. Këtu paraqiten metodat e ndryshme të përdorura në studim, si dhe ato statistikore. Informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm që të lejojë referimet.

Rezultatet dhe diskutimet duhet të jenë të qarta dhe të ilustruara në tabela dhe grafikë. Rezultatet eksperimentale duhet të analizohen statistikisht dhe të nxirren përfundime në bazë të një besueshmërie statistikore. Të njëjtat rezultate të dhëna me tabela nuk mund të jepen edhe me anën e grafikëve dhe anasjelltas.

Konkluzionet: Konkluzionet që vijnë nga rezultatet e paraqitura duhet të diskutohen në mënyrë të plotë, të lidhen direkt dhe të mbështeten në rezultatet e arritura. Konkluzionet nuk duhet të jenë spekulative, të merren prej literaturës, njohurive të përgjithshme e spontane.

Tabelat:

- Përmasat e tabelave, figurave dhe fotografive nuk duhet të kalojnë përmasat **12 cm në gjerësi x 18 cm në gjatësi**.
- Tabelat duhet të vendosen në pikat e duhura të tekstit, midis paragrafëve, jo brenda tyre.
- Të gjitha tabelat duhet të kenë numrat dhe titujt e tabelave dhe duhet të referohen me numrin e tabelës në tekst.
- Numri dhe titulli i një table duhet të vendosen sipër, jashtë tabelës dhe në qendër të tabelës. Fonti 10, vetëm emërtimi i tabelës me Bold, dhe përshkrimi vetëm Italic. Shembull: **Tabela 1. Të dhënat e përgjithshme të studimeve**
- Tabelat duhet të ndërtohen përmes përdorimit të funksionit Tabelës në Microsoft Word dhe nuk duhet të përfshijnë imazhe ose objekte. Ato nuk duhet të përmbajnë hapësira të panevojshme. Tabelat që janë shumë të gjata ose shumë të gjera për një faqe të vetme mund të shtypen në një madhësi fonti më të vogël ose të vazhdojnë në faqen tjetër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORATI

Figurat:	<ul style="list-style-type: none">• Figurat, të cilat përfshijnë grafikë, tabela, harta, vizatime dhe fotografi, duhet të kenë një ndikim material në përmbajtjen e një artikulli dhe nuk duhet të përdoren për qëllime dekorative.• Figurat duhet të vendosen në pikat e duhura të tekstit, midis paragrafëve, jo brenda tyre.• Të gjitha figurat duhet të kenë numra dhe tituj figurash dhe duhet të referohen me numrin e figurës në tekst. Numri dhe titulli i figurës duhet të vendosen sipër dhe jashtë figurës. Fonti 10, vetëm emërtimi i figurës me Bold, dhe përshkrimi vetëm Italic. Shembull: Figura 1. <i>Të dhënat e përgjithshme të studimeve</i>• Figurat duhet të jenë me cilësi të lartë dhe duhet të përshtaten në një faqe.
Akronimet:	Mos përdorni shkurtesa jo standarde nëse ato nuk shfaqen të paktën tri herë në tekst. Mbani shkurtimet në minimum.
Shënimet / Footnotes:	Shënimet janë të vendosura në fund të një faqeje. Ata citojnë referenca ose komentojnë një pjesë të caktuar të tekstit mbi të. Shënimet i referohen burimeve përkatëse - ata i bëjnë të ditur lexuesit tuaj se nga ka ardhur një material i caktuar, ose ku mund të kërkojnë burime të tjera mbi këtë temë.
Referencat:	<p>Referencat renditen në fund të punimit. Ju lutemi sigurohuni që çdo referencë e cituar në tekst të jetë gjithashtu e pranishme në listën e referencave (dhe anasjelltas). Rezultatet e pabotuara dhe komunikimet personale nuk rekomandohen në listën e referencave.</p> <p>Citimet e literaturës përgjatë artikullit duhet të bëhen duke përdorur emrin e autorit, të dy autorëve, ose të autorit të parë: p.sh. në përdorimin drejtpërdrejt në periudhë: Uherkovich (1963); Brakefield & Dowdeswell (1985); Van den Hoek et al. (1995); ndërsa në citimin e përgjithshëm: (Uherkovich, 1963; Brakefield & Dowdeswell, 1985; Van den Hoek et al., 1995). Literatura duhet të shkruhet qartë dhe e plotë, gjithë autorët, titulli i plotë, emri kuptueshëm i botuesit dhe faqet, si më poshtë (për librat dhe artikujt shkencorë përkatësisht):</p> <p>Literatura në fund të artikullit:</p> <p>Brakefield P. M. (1982): The ecological genetics of quantitative characters of <i>Maniola jurtina</i> and other butterflies. In: The biology of butterflies. Symposia of the Royal Entomological Society, London. No. 11: 167-190</p> <p>Brakefield P. M., Dowdeswell W. H. (1985): Comparison of two independent scoring techniques for spot variation in <i>Maniola jurtina</i> (L.) and the consequences of some differences. <i>Biol. J. Linn. Soc.</i> 24: 329-345</p> <p>Uherkovich G. (1963): Contributions a' la connaissance du potamoplankton de quelques fleuves de l'Albanie. <i>Acta Botanica, Ac. Sci. Hungaricae</i>, vol. 9: 161-172</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORATI**

Për një sistem referimi korrekt dhe të unifikuar do sugjerim të përdorni Mendeley Reference Manager ose paketa të tjera të menaxhimit të referencave të cilat ndihmojnë në menaxhimin dhe shkrimin e referencave. Për më shumë detaje ndiqni guidën <https://www.mendeley.com/guides/apa-citation-guide>.